



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushe-Arrez,Email:info@bashkiafushearrez.gov.al

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Fushe-Arrez me, \_\_\_/\_\_\_/2025

**Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS – “Blerje fadrome”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT  
(CPV):34144400-2 Automjete per mirembajtjen rrugore**

**VLERA E FONDIT LIMIT – 6 790 000** (gjashte milion e shtateqind e nentedhjet mije) **leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrez**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për proceduren e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Te kete ne ekstrakin e QKB-se blerje dhe shitje mjetesh motorrike te ketij lloji.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 40, pika 5 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 1 germa b, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Vendosija e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues eshte ne gjendje per te permbushur me sukses kontraten.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 që tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor,

**për vitin 2024** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument ne momentin e dorezimit te dokumentave).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore .

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë staf Teknik:

1-Ing.Mekanik pjestar i liçences se shoqerise me kohe te plote per te pakten 6 muaj para dates se hapjes se ofertave dhe te jete ne liste pagesa, per kete duhen:

a-Kontrate pune e vlershme ,

b-Diplome

c-CV.

2-Mekanik, me kohe te plote per te pakten 6 muaj para dates se hapjes se ofertave dhe te jete ne liste pagesa per kete duhen:

a-Kontrate pune te vlershme

b- Deshmi nga IQT.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 40, pika 5 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 1 germa b, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të vërtetuar që subjekti që realizon kontratën disponon stafin e duhur teknik për realizimin e sajë.

#### 2.3.2 Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë ÇertifikatënISO)

Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001-2015 (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë ÇertifikatënISO).

Çertifikatën ISO 45001:2018(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë ÇertifikatënISO).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77,të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin

publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit te cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde e cilësi e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese katalog per mjetin, ku te jete specifikuar produkti dhe specifikimet teknike, per te gjetur pasqyrim per parametrat teknike te produkti te kerkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 40, pika 6 germa 6 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Ky kriter shërben per te vertetuar qe subjekti qe realizon kontraten disponon mjetin e kerkuar sipas parametrave teknike te kerkuar nga autoriteti kontraktor dhe te ofruar nga operatori ekonomik.